



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:264446
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05837629

K.Dh.Sh II.nr.690/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna Drenas/Gllogoc - Drejtoria për Zhvillimin Ekonomik - DZHE, me seli në Gllogoc, rruga "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci", kundër debitorit "GP Metal" SH.P.K., me NUI: 810322248, me seli në Gllogoc, rruga "Ibrahim Rugova" Korroticë e Epërme, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi, avokatë nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.956/23 të datës 31.10.2023, me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Komuna Drenas/Gllogoc - Drejtoria për Zhvillimin Ekonomik - DZHE, me seli në Gllogoc, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.956/23 të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.956/23 të datës 31.10.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar propësimin e debitorit GP Metal" SH.P.K., ashtu që është anuluar urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.432/23 i datës 07.04.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Curri dhe është përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjës faktike si dhe për shak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Debitori nëpërmjet përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që refuzoj në tërësi si të pabazuar ankesën e kreditorit dhe të vërtetoj Aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.956/23 të datës 31.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna Drenas/Gllogoc - Drejtoria për Zhvillimin Ekonomik - DZHE, me seli në Gllogoc, ka paraqitur propozimin për në bazë të dokumentit përmbarimor Aktvendimit 05 Nr.431/01-20345 të datës 02.05.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit në emër të kompensimit për tatimin në pronë në shumën prej 1 ,616.29 €, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm dhe te njëjtat të barten në xhirollogarinë bankare të Komunës së Drenasit nr. ... kodi/...

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësueseve të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor duke theksuar ndër të tjerash se nuk është pronar i pronës në të cilën është ngarkuar me tatimin në pronë, por vetëm qiramarrës e cila vërtetohet nga kontrata për qiranë No-016 të datës 03.09.2009. Më tutje ka shtuar se në bazë të kësaj kontrate së qirasë në nenin 19 të saj nuk është paraparë detyrimi i qiramarrësit për tatimin në pronë, ashtu që debitori nuk mund të jetë subjekt i kësaj procedure përmbartimore, sepse nuk është pronar i paluajtshmërisë. Në lidhje me kërkesën e kreditorit ka deklaruar se sipas dispozitave të nenit 353 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD) ka arritur parashkrimi, për shkak se kreditori nuk ka iniciuar procedurë përmbartimore për realizimin e borxhit. Ka shtuar se Vendimi Nr. 03-432-02-27784 i datës 15.03.2023 është i kundërligjshëm, ngase nuk përmban asnjë element të afatit për përmbushje të detyrimit si dhe nuk përmban këshillën juridike për mjet juridik. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të detyrohet kreditorit që t'i paguajë shpenzimet e paraqitjes së prapësimit në shumën prej 312,00 € sipas tarifës së OAK, si dhe të përfundohet procedura përmbartimore e kreditorit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit në prapësim për faktin se dokumentet në bazë të cilave është i iniciuar propozimi për përmbartim janë dokumente me të gjitha tiparet e përmbartueshmërisë dhe është i ekzekutueshëm dhe i formës së prerë si dhe i pranuar në kohë nga ana e debitorit. Më tutje ka theksuar se në rastin konkret ka ushtruar veprimtari administrative në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe brenda kufijve të kompetencave. Ka shtuar se konstatimet e debitorit se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës e njëjta nuk qëndron, për shkak se legjislacioni në fuqi i cili e rregullon çështjen e tatimit në pronë nuk potencon me asnjë dispozitë që tatimi në pronë parashkruhet, Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbartim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.956/23 të datës 31.10.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit GP Metal" SH.P.K., ashtu që është anuluar urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.432/23 i datës 07.04.2023,

i lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Curri dhe është përfunduar në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se vendimi për ekzekutimin e detyrimeve tatimore Nr. 03-432/02-27784 te datës 15.03 2023, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përbarim të përcaktuara me nenin 24 par. 3 dhe 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, me çka rezulton se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat nuk i plotëson kushtet për përbarim që duhet t'i ketë dokumenti përbarimor, të parapara me nenin 24 par. 3 dhe 36 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se dokumenti mbi bazën e së cilave është lejuar përbarimi nuk paraqet titull ekzekutiv ashtu siç kërkohet me nenin 21 të LPP-së *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”* dhe nenit 36 par. 1 i cili përcakton se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”, të LPP-së.* Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, dokumenti-vendimi për ekzekutimin e detyrimeve tatimore Nr. 03-432/02-27784 te datës 15.03 2023, nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm e as titull ekzekutiv, pasi që i njëjti nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë ashtu sipas nenit 24 par.3 dhe 36 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë i ka vlerësuar pretendimet ankimore por të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta pasi që në këtë çështje juridike përmbarimore përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit i cili i nuk plotëson kushtet për përmbarim dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Sh.II nr.690/24 me datë 19.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2023:264446
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05837629